

Nr. 10686 Prot, datë 01 / 09 /2016

Marrëveshje Bashkëpunimi
ndërmjet
Bashkisë Shkodër
dhe
Organizatës "Gruaja tek Gruaja"

Bashkia Shkodër, me adresë: rruga 13 Dhjetori, nr 1, përfaqësuar nga Kryetarja e Bashkisë Shkodër **Znj. Voltana Ademi**, këtej e tutje e cilësuar si **Bashkia**


dhe

Organizatës "Gruaja tek Gruaja", me adresë: L. "Vasil Shanto", Rr. "Marin Barleti", Pallati 161, regjistruar si person juridik, Shoqatë, me nr. Vendimi 362, datë 06.09.2002, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; me nr. Liçence LN-6282-03-2013 me Nr NIPT K47312001N me seli në Shkodër, përfaqësuar nga **Znj. Majlinda Angoni**, Drejtore Ekzekutive, këtej e tutje cilësuar si **"Gruaja tek Gruaja"**.


Palët në këtë marrëveshje bashkëpunimi bien dakord për nënshkrimin e saj si më poshtë:


Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj Marrëveshje është përcaktimi i roleve dhe përgjegjësive të ndërsjellta në zbatimin e ndërhyrjeve që synojnë forcimin e sistemit të mbrojtjes së viktimave të dhunës në familje, ofrimin e shërbimeve cilësore për grupet më të marginalizuara si gratë dhe vajzat, viktimat të dhunës në familje, ofrimin e strehimit emergjent për këtë kategori, ofrimin e shërbimeve ligjore dhe psikologjike në kuadër të fuqizimit dhe ri integritetit të tyre në shoqëri dhe mbështetja e viktimave të dhunës familjare nëpërmjet këshillimit, fuqizimit, edukimit dhe ndërgjegjësimit për të bërë të mundur që ato të jetojnë një jetë të sigurtë dhe të ndershme.



1





BASHKIA SHKODER



Palët do të zbatojnë ndërhyrjet e përbashkëta në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi.

Neni 2 Baza ligjore

Kjo Marrëveshje bashkëpunimi lidhet në përputhje me Kodin e Familjes së Republikës së Shqipërisë; Ligjin nr. 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore"; Ligjin nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse" i ndryshuar; Ligjin nr. 9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" i ndryshuar; Ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" i ndryshuar; Ligjin nr. 9970, datë 24.7.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri"; Ligjin nr.10 221, datë 4.2.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi"; VKM nr. 626, 21.09.2004 datë "Për miratimin e listave të inventarit dhe transferimin në pronësi të Bashkive dhe Komunave të disa pronave të paluajtshme shtetërore që do të përdoren për ngritjen e Qendrave të shërbimeve sociale"; VKM nr. 658, datë 17.10.2005 "Për standartet e shërbimeve shoqërore"; VKM nr. 505, datë 13. 07. 2011 "Për Standartet e Shërbimeve Të Përkujdesit Shoqëror për Viktimat e Dhunës në Familje" në Qendrat Rezidenciale Publike dhe Jopublike"; VKM nr. 334 datë 17.02.2011 "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij";


Neni 3 Qëllimi

Kjo marrëveshje ka për qëllim rregullimin dhe forcimin e bashkëpunimit institucional ndërmjet Bashkisë së Shkodrës dhe Organizatës "Gruaja tek Gruaja" në kuadër të mbështetjes dhe promovimit të të drejtave të grave e vajzave, viktimat të dhunës në familje, fëmijëve në situatë ekstreme ruge dhe gjithashtu, angazhimin në parandalimin e fenomenit dhunë në familje.

Neni 4 Roli dhe përgjegjësitë e Gruaja tek Gruaja

Gruaja tek Gruaja merr përsipër këto angazhime:

1. Në kuadër të ofrimit të shërbimeve të strehimit emergjent të përkohshëm për viktimat e dhunës në familje.
- Të ofrojë shërbimin e strehimit emergjent të përkohshëm pranë strehëzës për viktimat e dhunës në familje, në përputhje me VKM nr. 505, datë 13. 07. 2011 për "Standartet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror për viktimat e dhunës në familje, në qendrat rezidenciale publike e jo publike"



BASHKIA SHKODER



- Gruaja tek Gruaja garanton mbështetje teknike profesionale dhe financiare në ofrimin e këtyre shërbimeve:
 - Strehimin emergjent të përkohshëm për viktimat e dhunës në familje, gra, vajza dhe fëmijë duke i ofruar ushqim veshmbathje dhe medikamente.
 - Mbështetje psikologjike dhe juridike për përfitueset.
 - Trajtim të specializuar psikologjik për djemtë dhe burrat dhunues;
 - Formim profesional dhe integrim social për gra dhe vajza;
 - Referim të rastit në grupin teknik të punës për dhunën në familje.
 - Në varësi të nevojave dhe problematikave që paraqet rasti, referohet në një strehëz tjetër për akomodim më të gjatë.
 - Siguron konfidencialitet, siguri fizike për cdo grua, vajzë, fëmijë, që merr shërbim në strehëz.
 - Të ofrojë strehim dhe shërbim për nënat dhe fëmijët të gjendur në rrezik të menjëhershëm deri në 72 orë në kuadër të zbatimit të Planit Lokal të Veprimit të Fëmijëve në situatë rruge.
- Në kuadër të bashkëpunimit në zbatim të politikave kundër dhunës
 - Të bashkëpunojë me Bashkinë Shkodër dhe institucionet publike e jo publike, në menaxhimin e rasteve të dhunës në familje;
 - Të bashkëpunojë me Bashkinë Shkodër dhe institucionet në varësi, në planifikimin dhe organizimin e aktiviteteve të përbashkëta të organizuara në kuadrin e zbatimit të programit ndërgjegjësues, sensibilizues dhe parandalues kundër dhunës në familje;
 - Të ofrojë mbështetje për strukturat e shërbimit social në nivel Bashkie për vlerësimin e nevojave të grupeve vulnerabel (gra vajza dhe fëmijë që përjetojnë situata dhune në familje ose që janë në situatë rruge ekstreme) ndërtimin e planeve të ndërhyrjes dhe sistemin e referimit të rasteve të dhunës në familje.
 - Të mbështesë krijimin, funksionimin dhe ngritjen e kapaciteteve të organizatave jo fitimprurëse në Shkodër për koordinimin e nismave të advokacisë dhe sensibilizimit të opinionit publik në përmbushjen e të drejtave të viktimave të dhunës në familje, gra vajza dhe fëmijë;
 - Të mbështesë dhe fuqizojë mekanizmin e referimit dhe koordinimit mes strukturave të shërbimit social për menaxhimin e rasteve të grave vajzave dhe fëmijëve të cilat kanë përjetuar dhunë në familje;
 - Të ofrojë mbështetje në hartimin e manualit të funksionimit dhe koordinimit të sistemit të referimit;





Përgjegjësitë në lidhje me objektin


- Gruaja te Gruaja duhet të përdorë ambientet e objektit të vënë në dispozicion nga Bashkia Shkodër sipas objektit dhe qëllimit të kësaj marrëveshjeje.
- Gruaja te Gruaja angazhohet të kujdeset për ruajtjen nga vjedhjet, dëmtimet, zjarri dhe ta mirëmbajë ambientin e dhënë si dhe çdo detyrim tjetër i parashikuar në dispozitat ligjore.
- Gruaja te Gruaja është përgjegjëse për pagesën e faturave të ujit dhe të energjisë elektrike dhe kostove tjera operative për mirë ofrimin e shërbimeve në këtë ambient.
- Gruaja tek Gruaja angazhohet të paraqesë pranë Bashkisë Shkodër informacion të shkruar në mënyre periodike, çdo muaj, mbi ecurinë e ndërhyrjeve të saj në kuadër të ofrimit të shërbimeve të strehimit emergjent (nr. e klientëve të sistemuar për muajin, problematikat dhe ecuria e secilit rast) objekt i kësaj marrëveshjeje, arritjet dhe problematikat e hasura.
- Gruaja tek Gruaja angazhohet të garantojë parimin e ruajtjes së konfidencialitetit për cdo informacion që lidhet me gratë, vajzat dhe fëmijët, përfituese të shërbimeve që ofrohen nga shoqata Gruaja tek Gruaja.

Neni 5

Roli dhe përgjegjësitë e Bashkisë Shkodër

Bashkia Shkodër merr përsipër këto angazhime:

1. Në kuadër të ofrimit të shërbimeve të strehimit emergjent të përkohshëm për viktimat e dhunës në familje.
 - Të sigurojë ambientin për ofrimin e shërbimit sipas objektit të kësaj marrëveshjeje, objektin e ndodhur në Zonën Kadastrale 8593 me nr pasurie 6/164 sipas vërtetimit të dokumentit hipotekor me nr. 212 datë 13.7.2006, me sip. 110 m², në Rr. Lin Delija.
 - Bashkia do të ofrojë në vazhdimësi mbështetjen e saj për ecurinë e shërbimit strehëzës si dhe do të krijojë të tëra lehtësitë e mundshme për ecurinë e veprimtarive të këtij shërbimi.
2. Në kuadër të bashkëpunimi në zbatim të politikave kundër dhunës në familje
 - Të bashkëpunojë me Gruaja te Gruaja dhe institucionet në varësi, në menaxhimin e rasteve të dhunës në familje;
 - Të bashkëpunojë me Gruaja te Gruaja dhe institucionet në varësi, në planifikimin dhe organizimin e aktiviteteve të përbashkëta të organizuara në



BASHKIA SHKODËR



- kuadrin e zbatimit të programit ndërgjegjësues, sensibilizues dhe parandalues kundër dhunës në familje;
- Të koordinojë krijimin, funksionimin dhe ngritjen e kapaciteteve të organizatave jo fitimprurëse në Shkodër për koordinimin e nismave të advokacisë dhe sensibilizimit të opinionit publik në përmbushjen e të drejtave të viktimave të dhunës në familje, gra vajza dhe fëmijë;
 - Të bashkëpunojë për ndërtimin e mekanizmave monitorues të cilësisë së shërbimeve dhe të ngrejë kapacitetet e tyre në matjen e indikatorëve të cilësisë, referuar standarteve;
 - Të koordinojë takimet e Grupit Teknik të Punës kundër dhunës në familje.
 - Të koordinojë sistemin e menaxhimit të referimit të rasteve për dhunën në familje.

Neni 6 Zbatimi i Marrëveshjes

Palët përgjigjen reciprokisht për përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve të parashikuara në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi.

Bashkia Shkodër dhe Gruaja tek Gruaja caktojnë një person kontakti përgjegjës për komunikimin mes palëve, koordinimin e veprimeve dhe monitorimit hap pas hapi të zbatimit të përgjegjësive të përcaktuara në këtë marrëveshje.


Neni 7 Kohëzgjatja

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj dhe do të jetë e vlefshme deri Mars të 2019.

Palët mund të ndryshojnë ose të shtojnë në këtë Marrëveshje. Çdo ndryshim apo shtesë në këtë Marrëveshje bëhet vetëm më shkrim dhe nënshkruhet nga të dyja palët.

Neni 9 Përfundimi i marrëveshjes

- Secila nga palët mund të përfundojë këtë Marrëveshje në rastet kur:
- mbaron afati i kohëzgjatjes i përcaktuar në këtë marrëveshje;
 - shkelen dispozitat e ligjit dhe të marrëveshjes;
 - palët nuk i përmbahen qëllimit dhe objektit të marrëveshjes;
 - për forcë madhore.



BASHKIA SHKODËR



Secila nga palët duhet të njoftojë palën tjetër me shkrim, jo më vonë se 30 ditë përpara përfundimit të marrëdhënieve të Marrëveshjes, duke dhënë edhe sqarimet përkatëse të hollësishme dhe të qëndrueshme mbi këtë ndërprerje.

Për çdo rast pavarësisht mënyrës së përfundimit të, secila nga palët është e detyruar të përmbushë të gjitha përgjegjësitë e saj që burojnë nga kjo Marrëveshje deri në castin e ndërprerjes së marrëdhënieve.

Neni 10

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve zgjidhen me mirëkuptim, me bisedime ndërmjet tyre, deri në gjetjen e një zgjidhjeje të përbashkët.

Neni 11

Dispozita të fundit

Palët përgjigjen reciprokisht për përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve të parashikuara deri në fund të marrëdhënieve të kësaj marrëveshje bashkëpunimi, për të qënë partnerë në zbatimin e saj, duke punuar së bashku për realizimin e qëllimit të marrëveshjes.


Marrëveshja mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet një dokumenti me shkrim të nënshkruar nga të dyja palët.

Neni 12


Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga palët. Hartohet në 4 kopje të barazvlefshme në gjuhën shqipe, nga një kopje për secilën palë.

Për Bashkinë Shkodër


Znj. Voltana Ademi

Për "Gruaja tek Gruaja"


Znj. Majlinda Angoni